



Pranuar / Dorezuar Prilapjen / Prilapjen Received / Received	01.02.23	Viti god Year	
Organ / Njësia Org. / Unit	Nr. Prof. Prilapjen / Prilapjen	Shtesa Prilapjen Appendix	Sasia Koliciteti Quantity
SHKESHICK	1207 / 2023		112



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.03/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës A.nr.03/2023 të datës 04.01.2023, të parashtruar nga ankuesi nga Gjakova, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 01.02.2023, mori këtë:

### V E N D I M

*Përfundon procedimi administrativ* i filluar me ankesën me numër A.nr.03/2023 e datës 04.01.2023 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Gjakovës, më datë 04.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 04/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për harmonizim të koeficientit nga gashtë (6) në koeficientin shtatë (7).

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë për objekt çështjen e harmonizimit të koeficientit të pagës, thekson faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti hynë në fuqi një (1) muaj pas publikimit në gazetë zyrtare, me datë 05.02.2023. Me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publikë, duke përfshi



edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 është përcaktuar së gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marr parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës nga pala ankuese kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton se objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimmarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### Këshillë juridike:

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.03/2023

**Avdyll BEKTESHI**

*Procesmbajtës*

**Malsorë GASHI-BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*

#### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.